

**ADMINISTRIMI I MBETJEVE QARKU KORÇË**
NJËSIA E PROKURIMIT

Maliq më: 17/04/2026

PROCES-VERBAL-Tipi i Kontratës – MALLRA**“Pjesë Ndërrimi, solucione dhe shërbime mirëmbajtje për Impiantin RO për vitin 2026”**

Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim .
(Ky proces-verbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik (i ndryshuar)”, dhe nenit 78, pika 2 e të VKM nr. 285, datë: 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar)”, autoriteti/enti kontraktor ”Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë” ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Objekt i kontratës :

**“Pjesë Ndërrimi, solucione dhe shërbime mirëmbajtje për Impiantin RO për vitin 2026”
(Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara)**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik (i ndryshuar)”, dhe nenit 78, pika 2 e të VKM nr. 285, datë: 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik (i ndryshuar)”, autoriteti/enti kontraktor Administrimi i Mbetjeve të Qarkut Korçë ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT .

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Shtojca 1: **Formulari i Ofertës Ekonomike.**

Shtojca 3: **Listat e Çmimeve të artikujve .**

Shtojca 9 : **Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.**

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet **76, 82 dhe 83** të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik (i ndryshuar)”, nenit **26**, të VKM nr. **285**, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik(i ndryshuar)”.



2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Vetëdeklarimi sipas KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, (Shtojcat)
Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19/05/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik(i ndryshuar)”.

2.2.Për kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

Shtojca 1: **Formulari i Ofertës Ekonomike.**

Shtojca 3: **Listat e Çmimeve të artikujve**

Shtojca 9 : **Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit.**

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Kopje të deklaratave për xhiron vjetore **2022,2023,2024** , ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **30%** e vlerës së fondit limit të kontratës që po prokurohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kesaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3 e LPP, si dhe në nenin 43 të VKM nr285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik".

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bazuar në Ligjin nr 8438 date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi të Ardhurat" , i ndryshuar , Udhëzimit të Ministrit të Financave nr 5 datë 30.01.2006, " Për Tatimin mbi të Ardhurat", i ndryshuar, VKM nr 922 datë 29.12.2014 "Për deklarinimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore , vetëm nëpërmjet formës elektronike". Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2 gërma (c) të nenit 43 ,Seksioni III të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik".

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësisimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Shenim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohe sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të



ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

2.2.2 . Kopje të vërtetuar të bilancit për vitet **2023,2024** , të paraqitur dhe konfirmuar pranë autoriteteve përkatëse me nënshkrim dhe vulë si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar në përputhje me ligjin nr. 10091 , datë: **05/03/2009** " Për auditimin ligjor , organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" , i ndryshuar , Kreu V , neni 41 , pika c : shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar , të cilat zbatojnë për raportimin financiar standartet kombëtare të kontabilitetit , kur në mbyllje të periudhës kontabël për dy vite rradhazi tejkalojnë dy prej treguesve të mëposhtem:

- i) totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumë prej 50 milionë lekësh,
- ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumë prej 100 milionë lekësh,
- iii) ka mesatarisht 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël .

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme ,nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik". Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës , konkretisht është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 e Ligjit nr 8438 date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi të Ardhurat" , i ndryshuar , si dhe kërkesave të Ligjit nr 25 të vitit 2018" Për konntabilitetin dhe pasqyrat financiare" .

Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST. Shënim: Në lidhje me momentin e paraqitjes së dokumentacionit dëshmuës për kërkesat që përfshihen në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën në rastin kur OE shpallet fitues, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor, referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si edhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese



të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore, sipas përcaktimeve të Vendimit të Këshillit të Bashkisë përkatëse, pranë njërive të qeverisjes vendore ku operatori ekonomik ushtron ose ka ushtruar aktivitet për vitin **2025** sipas Ekstraktit të Rregjistrimit Tregtar, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 5, pika c, sipas afateve të miratuara të kryerjes së pagesave të përcaktuara nga çdo njësi e qeverisjes vendore. Kriteri konsiderohet i përmbushur me plotësimin e formularit sipas shtojcës 8 të DT. Dokumentat e kërkuara më sipër do të paraqitën referuar përcaktimeve të nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, ose nëse kërkohen sqarime nga autoriteti kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Furnizime dhe shërbime të ngjashme me një vlerë jo më të vogël se **20%** të vlerës së fondit limit, të realizuar gjatë tre viteve të fundit të aktivitetit të operatorit, e vërtetuar me :

- Kontratën përkatëse

Dhe

- Vërtetimin përkatës nga Autoriteti Kontraktor për realizimin me sukses të kontratës.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuar, e firmosur nga të dy palët.

Plotësimi i njërës prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 4 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4/b), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të vogël se **20%** të vlerës së fondit limit, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.



Përcaktimi i vlerës për kontratat e ngjashme është përcaktuar referuar bazës ligjore sa më sipërcituar dhe vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet. Referuar sa më sipër dhe me qëllim njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë, përvojën e duhur në funksion të realizimit me sukses të kontratës autoriteti kontraktor ka përcaktuar vlerën për kontratat e ngjashme.

2.3.2 Operatori ekonomik të paraqesë dokumentacionin e stafit teknik si më poshtë :

- **1 (një) Inxhinier Elektrik**, shoqëruar me kontratë pune të vlefshme .
- **1 (një) teknik Impiantesh** me kontratë pune të vlefshme .

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ b) dhe c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që kontraktuesi duhet të ketë staf për realizimin e shërbimit të mirembajtjes së impiantit për zbatimin e objektit dhe në përputhje me kushtet teknike të zbatimit të tij. Dokumentacioni plotësues i kërkuar në kriteret e vecanta për kualifikim pjesë përbërëse e dokumentave të tenderit është vendosur për arsye se me paraqitjen e këtij dokumentacioni vërtetohet se ky person përgjegjës është operativ pranë Ofertuesve të mundshëm dhe në këtë mënyrë Autoriteti Kontraktor krijon bindjen se Operatorët ekonomikë pjesëmarrës zotërojnë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të objektit që prokurohet. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Nga ana teknike argumentojmë ky kriter për të patur në staf një inxhinier mekanik dhe 1 teknik impiantesh është caktuar në bazë të kompleksitetit dhe rëndësisë së madhe që ka objekti i prokurimit për Autoritetin Kontraktor. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shpëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.



2.3.3 Operatori Ekonomik të paraqesë certifikata të vlefshme për sistemin e menaxhimit të cilësisë SSH EN – ISO 9001: 2015.

Argumentimi : Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Nenit 79, pika 1 të ligjit nr 162 dt 23.12.2020 per “Prokurimin publik” si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 44 ku cilësohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”. Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë certifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes. Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 ”Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 44 ”Kërkesat e cilësisë” , si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjensisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 ,për “Hartimin e Kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me certifikatat ISO.

2.3.4. Operatori Ekonomik të paraqesë certifikata të vlefshme për sistemin e menaxhimit të mjedisit SSH EN ISO 14001: 2015 .

Argumentimi : Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Nenit 79, pika 1 të ligjit nr 162 dt 23.12.2020 per “Prokurimin publik” si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 44 ku cilësohet se:

“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”.

Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga



organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes. Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 44 "Kërkesat e cilësisë" , si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjensisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 ,për "Hartimin e Kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me çertifikatat ISO.

2.3.5. Operatori Ekonomik të paraqesë certifikata të vlefshme për sistemin e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë ISO 45001:2018 .

Argumentimi : Kjo kërkesë është vendosur sipas përcaktimit të bërë në mbështetje të Nenit 79, pika 1 të ligjit nr 162 dt 23.12.2020 per "Prokurimin publik" si dhe në mbështetje të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik, neni 44 ku cilësohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit". Çertifikata duhet të jetë e vlefshme dhe e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga RSH ose standardeve shqiptare mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, secili operator ekonomik duhet të dorëzojë çertifikata ISO, sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes. Për kriteret e përcaktuara në Kapacitetin teknik, Njësia e prokurimit ka zbatuar VKM Nr.285 date 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 44 "Kërkesat e cilësisë" , si dhe bazuar në Rekomandimin e Agjensisë së Prokurimit Publik nr.8197 prot. datë 03.09.2018 ,për "Hartimin e Kritereve për kualifikim për procedurat e prokurimit për mallra,punë,shërbime. Autoriteti Kontraktor kërkon që operatori ekonomik të jetë i certifikuar me çertifikatat ISO.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.



Specifikimet Teknike për mirëmbajtjen e Impjantit RO

Impianti RO është prodhuar nga TDL Energie GmbH, Neumünster / Gjermani dhe specifikimet e tij janë dhënë në tabelën e mëposhtme:

Impjanti RO është instaluar në një kontenjer të rindërtuar 40 '. Kontenjeri përmban pajisjet që janë të nevojshme për procesin e impjantit RO, përfshirë: tubacione, pompa, filtra, valvola etj.

Një gamë e pajisjeve matëse mundësojnë monitorimin dhe regjistrimin gjithëpërfshirës të parametrave përkatëse. Rregullimi dhe kontrolli i impjantit RO bazohet në të dhënat e regjistruara të matjes dhe informacionin e dhënë nga një nivel gjithëpërfshirës i parametrave. Sistemi elektrik i kontrollit të njësisë RO është i instaluar në një dhomë të veçantë brenda kontenjerit.

Funksioni i tubit është prodhuar dhe instaluar në përputhje me rregulloret e DVGW. Të gjitha pjesët, të cilat janë të ekspozuara ndaj ujit të ndotur ose koncentratit të ujit të ndotur, janë rezistent ndaj ujit të vend depozitimit dhe koncentratit të tij.



Specifikime		Impianti RO
Tipi		2-faza
<u>Hidraulike</u>		RO-13_120_2_03
Kapaciteti Nominal	(m3/h)	4,3
Permeati i Kapacitetit Nominal	(m3/d)	75,0
Kapaciteti	(m3/d)	100
Disponueshmëria Teknike	(%)	>90
Presioni maksimal i operimit	(bar)	55
I përshtatshëm për		Uji i Ndotur
Përmbajtja maksimale e solideve	(mg/l)	50
Madhësia minimale e parafiltrit të kërkuar	(µm)	20
Hyrja e ujit të ndotur	(d)	63
Lidhja	(Typ)	GF tub
Koncentrimi	(d)	40
Dalja	(Typ)	GF tub
Lidhja	(d)	40
Dalja e permeatit	(Typ)	GF tub
Lidhja	(d)	63
Uji i daljes	(Typ)	GF tub 9 x12 mm PTFE
Acidi lidhës		mbrojtës i Vidhave Serto/Tubi lidhës 1 1/2"
Lidhja hyrëse		9x12mm PE
Lidhja hyrëse e sodës kaustike		mbrojtës i Vidhave Serto/Tubi lidhës 1 1/2"
<u>Materiali</u>		
Tubat PN10		PVC-U
Tubat PN63		1.4571, e lemuar
Tubat e acidit		PTFE
Tubat e sodës kaustike		---
Struktura		1.4571
<u>Elektriku</u>		
Sistemi Elektrik		TNS
Tensioni	(V)	400 / 230
Faza		3 / 1
Frekuenca	(Hz)	50
Fuqia e instaluar	(kW)	64
Fuqia operative	(kW)	40
Mbrojtja e siguresave elektrike	(A)	160
cos phi		0,7
<u>Dimensionet dhe peshat</u>		
LxWxH	(mm)	12.190 x 2.438 x 2.590
Pesha neto	(kg)	16.000



Impianti RO përbëhet nga tre faza, të cilat janë të lidhura në seri në anën e permeatit.

Faza e parë e sistemit të membranave përbëhet nga tre blloqe. Një bllok përbëhet nga dy tuba presioni, një pompë riqarkullimi, teknologji matëse dhe pajisje lidhëse.

Uji furnizohet në bllokun e parë nën një presion normal prej 25 deri në 55 bar. Këtu, ai përzihet me rrjedhën qarkulluese dhe furnizohet me elementët gjarpëruese të bllokut të parë nga pompa e riqarkullimit. Në këto elementë gjarpëruese, një pjesë e ujit ndahet dhe quhet permeate. Permeati grumbullohet dhe ushqehet në fazën e dytë e cila funksionon në një mënyrë të ngjashme.

Pas fazës së 2-të, permeati mund t'i nënshtrohet një procesi të zhveshjes së jashtme për të rregulluar vlerën e pH të kërkuar për shkarkimin.

Pjesa tjetër e ujit të ndotur është referuar si koncentrat. Një pjesë e koncentratit kalohet në bllokun tjetër, ndërsa pjesa tjetër kthehet në qarkullim me hyrjen, në mënyrë që të përzihet. Kjo përsëritet në bllokun tjetër.

Përqendrimi i kaluar nga blloku i tretë derdhet përmes njehsorit të rrjedhës dhe në rezervuarin e koncentratit. Valvula e kontrollit rregullon nivelin e përcaktuar të rrjedhës së koncentratit dhe rrjedhimisht presionin në fazë. Koncentrati hidhet siç duhet nga jashtë në përputhje me legjislacionin e mbetjeve.

Fushëveprimi i Punëve të Mirëmbajtjes

Shërbimet e Kontraktuesit do përfshijnë të gjitha masat e përshkruara në nën-kapitujt e mëposhtëm që kërkohen si pjesë e mirëmbajtjes për një operim të sigurt, funksional dhe ekonomik të impiantit RO.

Në përgjithësi, Kontraktuesi duhet të:

- a) sigurojë shërbime të mirëmbajtjes, testim dhe inspektim të impiantit RO, siç detajohet në Programin e Mirëmbajtjes dhe Shërbimit të prodhuesit.
- b) të respektojë të gjitha statutet, rregulloret, ordinancat, marrëveshjet industriale, kërkesat e sigurisë, aktet nënligjore ose kërkesat e autoriteteve që kanë juridiksion mbi pronën.
- c) bashkëpunojë dhe koordinojë me kontraktorët e tjerë për të kryer punën.

Kryejë Punimet në përputhje me:

- a) kushtet e Marrëveshjes që do lidhet me Punëdhënësin
- b) të gjitha Ligjet dhe Lejet në fuqi
- c) të gjitha garancitë e zbatueshme të ofruara nga prodhuesit ose furnitorët
- d) të gjitha udhëzimet dhe specifikimet e mirëmbajtjes të prodhuesit
- e) kërkesat e çdo politike sigurimi të mirëmbajtur nga Kontraktuesi
- f) Të sigurojë të gjitha mjetet dhe pajisjet e nevojshme për të kryer punimet



Inspektimi dhe Mirëmbajtja Parandaluese

Kontraktuesi duhet të sigurojë një inspektim dhe mirëmbajtje parandaluese të impiantit RO çdo gjashtë muaj pas nënshkrimit të kontratës. Punimet që duhet të bëhen nuk përfshijnë vetëm punët që duhet të bëhen në intervalet gjysmë-vjetore dhe vjetore në planin e mirëmbajtjes por dhe ne evidentimin e problematikave të ndryshme që ka impianti për mirfunksionimin e tij në sistemet elektronike, elektrike, mekanike dhe hidraulike.

Stafi i Punonjësve do të marrë udhëzime përkatëse për punët e bëra.

Për këtë detyrë, Ofertuesit duhet të ofrojnë një çmim të përgjithshëm për mirëmbajtje parandaluese dhe inspektim, përfshirë të gjitha kostot, përveç kostove të pjesëve zëvendësuese dhe konsumimet e zakonshme. Pjesët që do të zëvendësohen do të faturohen veçmas, ndërsa harxhimet e zakonshme do të sigurohen nga punëdhënësi.

Mbështetja Teknike

Kontraktuesi duhet të sigurojë monitorim në distancë stafit të punëdhënësit të operacioneve të sistemit përmes lidhjes me internet. Pajisja e nevojshme është instaluar tashmë në impiantin RO të Punëdhënësit.

Nëse është e nevojshme, Kontraktuesi duhet të përcaktojë një plan veprimi për të zgjidhur problemin më të fundit në ditën e ardhshme të punës.

Stafi i Punonjësve do të kryejë aktivitetet e mirëmbajtjes ditore, javore, mujore dhe tremujore. Për të dhënë këshilla teknike dhe për t'iu përgjigjur pyetjeve të stafit të punëdhënësit, Kontraktori do të sigurojë një mbështetje të largët gjatë ditëve dhe orëve të zakonshme të punës; nga e hëna deri të premten, midis orës 08:00 dhe 17:00 me orën e Shqipërisë. Mjetet në distancë mund të jenë telefonike, posta elektronike ose shërbimet e lajmëtarëve të çastit.

Kontraktuesi duhet të sigurojë një përgjigje të përshtatshme për çdo kërkesë për ndihmë në ditën tjetër të punës.

Shërbime Opsionale për defekte të paparashikuara

Në bazë të monitorimit dhe mbështetjes në distancë, nëse stafi i punëdhënësit nuk është në gjendje të rregullojë defektin në impiantin RO, Kontraktori do të sigurojë një shërbim të riparimit në vend. Kontraktuesi do të paraqesë një vlerësim për punët e riparimit në bazë të çmimeve të njëjësive për mjeshterinë dhe pjesët rezervë siç ofrohet nga Kontraktuesi në ofertën e tij. Defekti do të korrigjohet brenda dy javësh pas marrjes së njoftimit nga punëdhënësi për të kryer punët e riparimit.



Pjesët e Ndërrimit dhe konsumit

Punëdhënësi mban një rezervë të pjesëve të ndërrimit dhe të konsumit me një numër dhe lloj të kufizuar të pjesëve. Sidoqoftë, mund të ketë nevojë për pjesë të mëtejshme ndërrimi dhe konsumit që nuk janë në dispozicion në Shqipëri. Kontraktuesi duhet të informoje punëdhënësin për pjesët që i nevojiten.

Regjistrat dhe Raportet

Kontraktuesi duhet të rifreskojë librin e regjistratit të mirëmbajtjes në vend depozitim të impiantit RO pas çdo aktiviteti mirëmbajtjeje dhe të sigurojë një certifikatë që thotë se mirëmbajtja parandaluese është kryer në përputhje me kërkesat.

Shërbime mirembajtje e riparime

Më poshtë tek tabela **1 dhe 2** janë paraqitur nevojat për shërbimet kryesore parandaluese dhe shërbimet për mirëmbajtjen teknike opsionale të riparimit në vend të defekteve e ndërhyrjeve të specializuara.

SHËRBIMET E MIRËMBAJTJES :

Shërbime Kryesore Tab.1

Shërbimi	Njësi	Sasia
Mirëmbajtja fillestare dhe parandaluese Kontroll i përgjithshëm i impiantit RO Problemet elektronike , elektrike , mekanike , hidraulike.	për mirëmbajtje	2
Mbështetje teknike per monitorim online dhe per kontrollin dhe riparimin e difekteve Suport online i vazhdueshem Riparim online i difekteve Mirmbajtje Programi Komunikim elektronik , telefonik dhe lajmerues.	mbështetje për orë pune	180 orë

**Shërbimet teknike-opsionale Tab.2**

Shërbimi	Njësi	Sasia
Suport Tekniku Riparimi i difekteve ne vend Sigurimi i riparimit brenda dy javeve nga evidentimi i difektit	Ditë - Punë	18
Shërbime teknike na prodhuesi i impiantit (TDL)		
Teknik TDL	punë-ditë	4
Udhetim	Vajtje ardhje	2

Pjesë ndërrimi dhe materiale

Impianti i trajtimit të ujit të ndotur me metoden e Reverse Osmosis ka nevojë për pjesë dhe materiale për të vijuar punën normalisht dhe pa ndërprerje gjatë vitit 2026.

Pjesët dhe materialet e nevojshme janë nxjerrë sipas nevojave dhe gjendjes në magazinë, për hartimin e listës është punuar në bashkëpunim me stafin dhe kontraktorin përgjegjës për mirëmbajtjen e impiantit.

Në tabelën 3 të mëposhtme janë pasqyruar pjesët dhe materialet e nevojshme:



LISTA E MATERIALEVE PËR FURNIZIM IMPIANTI RO:

Tab.3

Nr.	Përshkrimi	Njësia	Sasia
1	Membranë X-Tra SW 8040 HR-48OM	copë	2
2	Set gominash për pompat me numrat: 815279 (044543x2) -12398 - 44113 -48860 -43211 -44112 -48362 -14177-828710-100488 -126587-13296-11379-814279-049676-20189 -11345-44085-31040; seal kit	set	1
3	Transduktor presioni - 200 bar type WL52.XXX4AKD3BC1X ; temp -2..+60 celcius; 4-20mA;8-35V-: gjatësia 6m;material: Dupleks/AL203/EPDM PE ; IP68(30bar)	copë	3
4	Damper pompa (3531 AN A17007- NPTM,SS/NBR)	copë	1
5	Vaj për Pompën (3531 AN A17007)	litra	12
6	Sonda e temperaturës dhe lagështisë (FF-GLT-20MA-AF-TE 1)	copë	4
7	Dragesensor (ARMM-0102 Part No.6810435)	copë	2
8	Transmetues presioni (S-11 10Bar 9021230)	copë	2
9	Gomine depozita e BEG-FILTER Model: AFM12-2T-2 ID e pjesës:76255061; Temp: 0-90 gradë celcius; Presioni: 0-10 bar	copë	6
10	Qeliza matëse e përçueshmërisë (LF 3213-C0.5)	copë	2
11	Motor protection circuit breaker (3.5-5A 3RV2011-1FA10)	copë	4
12	RoPlant Automat 3 polar (5.30)	copë	2
13	Motor protection circuit breaker Siemens Sirius (0.55-0.8A 3RV2011-0HA10)	copë	2
14	RoPlant Modul Elektronik (5.26)	copë	2
15	Motor protection circuit breaker Siemens Sirius (2.8-4A 3RV2011-1EA10)	copë	2
16	RoPlant Automat (5.7; 5.8;5.9;5.11)	copë	4
17	RoPlant Çelës Kontrolli (5.39;5.42)	copë	2
18	RoPlant Modul Analog	copë	1
19	Valvul Notuese Unazore (1.8)	copë	1
20	RoPlant Çelësi i Kontrollit Primar	copë	1
21	RoPlant Tregues Sigurie	copë	1
22	Cartbridge filter 10 mikron	copë	150
23	Solucion Ndhima e shpejtë (Acid Sulfurik)	copë	1
24	Drozel Neon220V 58w/54-765	copë	4
25	Mbrojtëse plastike fytyre	copë	2



Impianti i trajtimit të ujit të ndotur që vjen nga landfilli dhe depozitohet për trajtim me metodën e Reverse Osmosis, për të vijuar punën normalisht dhe pa ndërprerje në vazhdim të punës, gjatë vitit ka nevojë për furnizim me solucione pastrimi me Ph të ulët, me Ph të lartë, Acid Sulfurik, Antiskalant etj që membranat e Reverse Osmosis dhe i gjithë sistemi hidraulik i montuar në këtë impiant të pastrohet rregullisht dhe sa herë të jetë e nevojshme.

Mbështetur në Buxhetin e miratuar për vitin 2026 përbërësit dhe sasi të nevojshme janë si më poshtë:

LISTA E SOLUCIONEVE PËR IMPIANTIN RO :

1- Për furnizimin me solucione pastrimi me Ph të ulët tek tabela nr.1 po japim specifikimet dhe të dhënat për sasi të nevojshme:

Tabela 1

<i>Solucion me pH të ulët (MCT113) ose të ngjashëm</i>	Specifikime
pH	3.0 ± 0.5
I projektuar posaçërisht për të hequr hidroksidet e metaleve Fe, Al, Mn, karbonat kalciumi dhe fosfat kalciumi shkallë të tjera të ngjashme nga osmoza e kundërt (RO), nanofiltrimi (NF) dhe ultrafiltrimi (UF)	Të përdoret në tretësirën: 2%
SASIA	400 kg

Tabela ½

<i>Acid citrik (C₆H₈O₇) monohidrat</i>	Njësia	Specifikime
Përmbajtja	%	99.9-100.5
Pamja	-	Pa ngjyre ose e bardhe, granulare ose puder
Uji	%	Uji % 7.5-9
Oksalate	ppm	360
Sulphated ash	%	0.10
Sulfate	ppm	150
Alumin	ppm	0.2
SASIA	kg	100



2-Për furnizimin me solucione pastrimi me Ph te lartë , tek tabela nr.2 po japim specifikimet dhe të dhënat për sasi të e nevojshme:

Tabela 2

<i>Solucion me pH te lartë</i> (MCT515,ultrasil 110 ose të ngjashem)	Specifikime
pH	12.0 ± 0.5
Për përdorim në heqjen e fulateve organike sic janë vajrat dhe bioproteinat nga elementët e membranës	
SASIA	400 kg

3-Për furnizimin me antiskalant që duhet të aplikohet për ujëra deti dhe ujëra të ndotura me certifikatë NSF/ANSI Standart 60, në Tabela 3 po japim specifikimet teknike dhe sasinë e kerkuar:

Tabela 3

ANTISKALANT	Lëng pa ngjyrë
Densiteti ne 20° C	1.15-1.25 kg/lt
pH(10%solucion)	5-7
Dozimi	2-5 mg/l
Te kete fuqi ndervepruese per:	
Calcium Carbonate	CaCO3
Calcium Sulfate	CaSO4
Barium Sulfate	BaSO4
Strontium Sulfate	SrSO4
Calcium Fluoride	CaF2
Silica	SiO2
SASIA	600 kg



4- Për furnizimin me acid sulfurik (H_2SO_4) ne tabela Nr 4 po japim specifikimet dhe të dhenat për sasi të e nevojshme:

Tabela nr.4

H_2SO_4	Lëng pa ngjyrë	% Përqëndrim	97.5- 98.5
Densiteti ne 20° C		kg/lt	1.845-1.850
Dioksid sulfuri	SO ₂	mg/kg	<5
Hekur	Fe	mg/kg	<15
Zink	Zn	mg/kg	<0.25
Plumb	Pb	mg/kg	< 0.03
Arsenik	As	mg/kg	<0.03
Bakër	Cu	mg/kg	<0.02
Merkur	Hg	mg/kg	<0.01
SASIA			14.000 Kg

5- Për Furnizim me hipoklorit natriumi qe perdoret per larje dhe dizifektme,te tabela Nr 5 po japim specifikimet dhe te dhenat per sasite e nevojshme:

Tabela Nr.5

Nr.	Parametrat	Njësia e matjes	Specifikat
1	Gjendja	-	Lëng i qartë
2	Ngjyra	-	E verdhë
3	Densiteti 20°C	gr / ml	1.13-1.24
4	Titulli Cl ₂	% (m/m)	13-15
5	Substancat toksike	mg / kg	Limitet në mg / kg të klorit të lirë
6	Arsenik (As)	mg / kg	max 1
7	Kadmium (Cd)	mg / kg	max 2.5
8	Krom (Cr)	mg / kg	max 2.5
9	Mërkur (Hg)	mg / kg	max 3.5
10	Nikel (Ni)	mg / kg	max 2.5
11	Plumb (Pb)	mg / kg	max 15
12	Antimon (Sb)	mg / kg	max 20
13	Selen (Se)	mg / kg	max 20
	SASIA		180 Kg



6- Furnizimi me ujë të distiluar (H₂O) sipas: GOST 6709-72 tek tabela nr.6 po japim specifikimet dhe të dhënat për sasi të e nevojshme:

Tabela Nr.6

Nr.	Parametrat	Njësia e matjes	Specifikat
1	Gjendja	-	Lëng
2	Pamja	-	Pa ngjyre e kthjellet transparente
3	Percueshmeria elektrike	GOST- 5µS / cm	2,0-2,2 µS / cm
	SASIA		20 litra

7-Për furnizim me bufera për kalibrim:

buffer solucion Ph 4.01 2 litra

buffer solucion Ph 7.01 2 litra

Afati i skadimit duke filluar nga viti aktual të jetë: **2 (dy) vjet.**

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”. Kujdes:Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT

Roald Neziri

Arjan Qirjas

Frederik Hamzallari